



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 09
Prishtinë, më 08 Maj 2012, në orën 11:00 salla N-225
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Adem Grabovci.

Të ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Mehmet Simnica-zyrtar i fushës për ekonomi, Albert Krasniqi- KIPRED, Butrint Ymeri - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.05.2012,**
3. **Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011,**
4. **Të Ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.05.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 02.05.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011

Kryetari – Tha se ZAP ka proceduar raportin vjetor të performancës. Komisioni do ta shqyrtoj këtë raport pavarësisht që pasqyrat e audituara financiare do të shqyrtohen, pasi ato të jenë proceduar në Kuvend. Ftoi auditorin që të prezantoi raportin.

z.Lars Lage OLOFSSON – Raporti 2011 përfshin përfundimin e sezonit të auditimit me 2011 dhe fillimin e sezonit të auditimit të vitit 2012. Numri i auditimeve është duke u ngritur, dhe këtë sezon janë planifikuar 105 raporte të auditimit, krahasuar me vitin e kaluar që ishin 89. Auditimi është duke u zgjeruar dhe duke iu adresuar fushave në një aspekt më të gjerë. ZAP është duke marrë pjesë në një numër të produkteve që janë duke nxjerrur, sa i përket menaxhimit të kontrollit të brendshëm, politikave të KBF-së, vendimeve të reja sa i përket pasqyrave financiare 9 mujore, vlerësimeve të KBF-së, rregullën financiare nr. 1 etj. Krahasuar me vitet e kaluara, ka një ulje të shpenzimeve, dhe kjo është e lidhur me shumë faktorë. Kjo do ta shihet në të gjitha institucionet, sa i përket pasqyrave financiare të vitit 2011. Pastaj, vendimet për buxhetin kanë zvogëluar shpenzimet për vitin 2011. Edhe kur është fjala për marrjen e personave të rinj, apo bërë investime, janë bërë kursime. Ky institucion ka partner deri në vitin 2015. Kur është fjala për projektet e binjakëzimit dhe ato bilaterale, janë bërë kyçjet e para në arenën ndërkombëtare, dhe këto efekte po shihen tash. ZAP është duke marrë pjesën në grupe punuese me vendet kandidate për BE-në. Janë në proces të caktimit të një zëvendësit të auditorit të përgjithshëm. Gjatë 2011-ës është bërë ristrukturimin i organizatës. Numri i stafit është rritur, dhe kjo është e rëndësishme pasi tash është duke u bërë një punë më e mirë. Janë 132 persona që punojnë në këtë institucion, dhe ka qene nën 80 para 2 viteve. Gjithashtu edhe buxheti është dyfishuar. Së bashku me partnerët tanë, është forcuar edhe më teje stafi, për të qenë në përputhje me kërkesat e ISAIT.

Valbona Dibra- Tha se Raporti është i përgatitur mirë, por nuk ka shumë dallim nga raporti i vitit të kaluar si nga numri i auditimeve ashtu edhe nga opinioni, përpos disa specifikave. Në raport thuhet se janë bërë tri auditime të performancës, janë kryer tri, ndërsa është publikuar një. A i ka shfrytëzuar menaxhmenti i ZAP-it kapacitetet ekzistuese të zyrës, që së paku institucionet që janë audituar, raportet e tyre të publikohen? Pse vetëm një raport i auditimit të performancës është publikuar? Sa i përket opinionëve të dhëna, dallimi nga viti i kaluar është vetëm te opinionet e pakualifikuara me theksim të çështjes që janë rritur dukshëm. Ka pasur rënie të opinionit të kualifikuar dhe ky është një tregues për përmirësimin e shpenzimit të parasë publike. Projektet e financuara nga BE – mjetet prej 433mijë euro, në cilën kategori ekonomike të shpenzimeve kanë hyrë? Janë 24 auditorë të certifikuar dhe nga organogrami shihen 13 pozita drejtor. A janë të gjithë këta drejtorë të certifikuar, apo ka edhe nga stafi tjetër si kontabilist, teknik etj?

z.Lars Lage OLOFSSON - Në faqe 5 në tabelën nr. 2 mund të shihni numrin e auditimeve të kryera. Dhe në këtë drejtim ka një progres të dukshëm. Sa i përket auditimeve të performancës, numri i tyre është relativisht i limituar. Arsyeja pse nuk janë kemi publikuar 2 nga këto raporte, ka qenë se kualiteti i tyre nuk qenë i duhur.

Për auditime të performancës duhen shkathtësi të tjera. Për këtë arsye ZAP është duke bashkëpunuar me qeverinë suedeze. Sa i përket auditimit të fondeve ndërkombëtare, këtë vit është në plan auditimi i projektit DANIDA. Është një projekt i UNIHABITATIT në Pejë, një Projekt në Prizren, etj. Të gjithë pagesat që vinë nga këto, shkojnë drejt në buxhetin e shtetit. Sot ZAP ka 28 auditorë të certifikuar.

Bali Muharremaj – Tha se nëse analizohet raporti krahasuar me vitin 2009/2010, ka progres. Kërkoj që në këtë vit të ketë më shumë auditime të performancës dhe dëgjime publike. Të opinionet e dhëna nuk ka shumë ndryshime në dhënien e opinioneve të kualifikuara domethënë janë 19, tri të kundërta dhe për 8 komuna auditimi nuk është kryer. Ka progres sa i përket stafit si në numër ashtu edhe në kualifikim. Ka një bashkëpunim të mirë kombëtar dhe ndërkombëtar. Kërkoj që në këtë vit të ketë auditim të performancës edhe të disa tenderëve si hyrja e barnave në Kosovë dhe auditimi i ndonjë rruge. Pyeti: kur do të kaloj ZAP në zyrë publike, e jo të vazhdoj të jetë në zyrë private. Në këtë vit kërkoj që politika të përzihet sa më pak në punën e ZAP-it. Në të kaluarën ka pasur ndërhyrje politike si p.sh te MPB dhe MD ka pas shkelje të mëdha. Raportet e ZAP nuk duhet votuar, sepse ZAP ka stafin profesional.

Murselj Haljilji- Tha se Komisioni ka përkrahur kërkesën e ZAP-it për tu rritur numri i auditorëve. Arsyeja pse ekziston numri i vogël i auditorëve është se ka pak njerëz që merren me këtë punë. Çka konkretisht ka ndërmarrë ZAP lidhur me këtë çështje, sepse në f.q. nr 12 shkruan se janë rritur shpenzimet për paga dhe mëditje, sepse është rritur numri i të punësuarve dhe një pjesë e shpenzimeve ka shkuar në aftësim profesional. A do të thotë se këta auditorë janë të përgatitur për auditim, apo duhet të investohet ende në ta për të kryer auditimin? Çka planifikon ZAP lidhur me këtë? Është brengosëse auditimi i performancës. Çka ka bërë ZAP për të rritur profesionalizmin e auditorëve të cilët do të jenë profesional për të kryer auditimin e performancës? A ka ZAP-i buxhetin e planifikuar brenda zyrës dhe nëse ka këtë plan a është në pajtim me të dhënat e prezantuara në këtë raport?

Ramiz Lladrovci – ZAP është në proces të rekrutimit të stafit të lartë. Si është baza ligjore për rekrutim? Sa anëtarë duhet t'i ketë Komisioni për rekrutim dhe kush emëron këtë Komision. Janë duke u bërë shkelje gjatë rekrutimit, duke emëruar staf teknik në pozita të larta. Sipas informacioneve në Komision marrin pjesë vetëm dy persona. A janë bërë përgatitjet e duhura që ZAP-i me rastin e përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare, ZAP të kaloj te vendorët detyrën në atë mënyrë që ata ta kryejnë punën në mënyrën më të mirë të mundshme? Donacionet ndërkombëtare prej 433 mijë euro, a do të jenë pjesë e auditimit të jashtëm dhe për cilat kategori janë përdorur? Kush është personi i tretë në Komision i cili ka bërë testin dhe ka kontrolluar testin?

Armend Zemaj – Besoj në pavarësinë e punës dhe institucionale e ZAP-it. Kjo ndoshta është rezultat edhe i bashkëpunimit me këtë Komision parlamentar. Në raport keni cekur se Komisioni është palë e interesit dhe mendoi që KMFP nuk është palë e interesit, por është mbikëqyrje parlamentare. Raportet e ZAP-it kanë qenë pasqyrë për të gjitha institucionet. Si deputet, të tentojmë që të kemi një auditor të pavarur që të mbrohen interesat e qytetarëve në shpenzimin e parasë publike. ZAP-i pyetjet e deputetit Ramiz, duhet t'i marr për bazë, sepse së paku ky institucion duhet të punoj i pa-politizuar. Janë kryer tri auditime të performancës, është publikuar një. Domethënë dy raporte pas konsultimit me ministrin e MF-së nuk janë publikuar. Çka janë këto konsultime? Auditimi i donacioneve nga jashtë - ka pas pak rëndësi që të bëhen këso lloj auditime në raport me donacionet e mëdha. P.sh është dashur të auditohen donacionet për KOST-in, pastaj donacionet që jepen për shkolla të mëdha dhe ato me implimentime që kapin shifra milionëshe. ZAP nuk bashkëpunon me prokurorin që merret me krime kundër korrupsionit.

Komisioni vazhdimisht është kujdesur që të përkrahet kërkesa buxhetore e ZAP-it dhe për këtë është kujdesur personalisht si deputet gjatë gjithë kohës. Por, kjo të kthehet në merita. Rekrutimet në ZAP, sipas raportit bazohen në merita. Për vitin 2011, zëvendës auditori i përgjithshëm është edhe kryesues i kabinetit. Dhe nëse rekrutimi bazohet në merita me siguri ky avancim ka ndodhur mbi këtë bazë. Propozoi që me punën që po bënë ZAP-i dhe me fondet që merren nga bashkësia ndërkombëtare, Kosovës t'i mbetet një institucion pa probleme.

Kryetari - Sipas raportit, për tetë Komuna auditorët nuk kanë mundur të japin opinion për

shkak të kufizimeve të fushëveprimit. Cilat janë ato komuna dhe cilat janë specifikat që kemi këtë gjendje? Sipas vlerësimit që i është bërë ZAP-it nga ZKSA në bashkëpunim me USAID, është thënë se ZAP-i është në rrugën e duhur, por i nevojitet mbështetje për të mundur të zbatoj plotësisht standardet ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik. A do të thotë kjo se deri më tani raportimet nuk janë bërë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit? Pastaj sipas raportit disa nga rekomandimet e ZAP-it nuk janë adresuar sepse kanë qenë shumë të përgjithësuara dhe jo-specifike. Kjo duhet sqaruar nga ZAP-i? Çfarë mbështetje i duhet ZAP-it që në vitin 2014 të kemin një institucion i qëndrueshëm dhe plotëson standarde të kërkuara. Stafi i licencuar brenda viti është vetëm një ose dy. Ky numër është shumë i vogël duke ditur nevojën për auditorë të certifikuar. Këto përgjigje Komisioni mund t'i marr edhe me raport shtesë bashkë me pasqyrat e audituara financiare në mënyrë që Komisioni të ketë pasqyrë të saktë rreth performancës së ZAP-it.

z.Lars Lage OLOFSSON – ZAP ka në plan të kryej auditim të performancës sa i përket mirëmbajtës së rrugëve. Të gjitha kontratat e 3 viteve të fundit janë në hetim nga prokuroria, dhe ZAP nuk i shikon këto gjëra kur ato janë nën hetim nga prokuroria. Lidhur me këto auditime, informatat në pasqyrat vjetore financiare, janë të vërteta dhe të sakta dhe mund të mbështeteni në ato informata. Pra, kritikë janë se si ato punë janë kryer. P.sh. MPB, një prej çështjeve ka qenë mungesa e menaxhimit të mirë të anës së kontrollit të brendshëm dhe komunikimit në mes të Ministrisë dhe Policisë. Pra, ky është auditim, dhe nuk është një institucion i ankimit se si është trajtuar kontrolli apo menaxhimi financiar. Nuk ka asnjë ndikim më të vogël politik. Sa i përket kontratës së zyrës, përfundon në shtatorin e këtij të viti, dhe kjo çështje është në agjendë. ZAP ka një plan të tillë siç e kanë edhe shumë organizatat buxhetore. Personi i tretë është menaxheri i burimeve njerëzore.

Donacionet ndërkombëtare prej 433 mijë euro, janë kosto për zyrën e auditimit të Suedisë, Anglisë, Holandës etj, që kur ata janë këtu për të monitoruar projekte të ndryshme. Emrimi i zëvendës auditorit të përgjithshëm, është në përputhje me ligjin. Të gjithë personat që kanë aplikuar janë testuar, pastaj intervistuar, dhe në këtë proces janë përfshirë njerëz që nuk kanë të bëjnë me punën tonë, si p.sh. Gani Gerguri. Pozita e auditorit të përgjithshëm është kushtetuese i cili pastaj me ligj e ka të lejuar që të emëroj zëvendës auditorin. Në këtë rast është bërë një proces i saktë, me një komision prej 3 personave. Personi i 3-te në komision është drejtori i burimeve njerëzore. Dhe i gjithë ky proces është shumë i drejtë, transparent, dhe në përputhje me ligjin.

Kur është fjalë e qasjes për auditimin e projekteve ndërkombëtare në Kosovë, tani jemi duke biseduar për nevojën për auditimin e 3 fondeve që janë duke u ngritur, si ato për shëndetësi, agrikulturë, etj. Kjo është duke u bërë, por nuk ka ndonjë vendim përfundimtar ende. Sa i përket atyre projekteve të vogla, kjo është një kërkesë e donatorëve të cilët nuk e bëjnë pagesën e fundit, pa u bërë auditimi. Bashkëpunimi me institucionet kundër-korrupsion, është i rregulluar me marrëveshjet që ZAP ka me ta. E vetmja gjë që duhet thënë është se auditorët e jashtëm që punojnë sipas standardeve ndërkombëtare, dhe nuk janë hetues që të kryejnë punën e tyre. Pra, sigurisht që ZAP i dërgonë raporte edhe EULEX-it, apo Agjesionit Kundër-Korrupsion. Qëllimi është të krijohet një institucion i cili do të ishte i pavarur, pa ndikime nga jashtë, dhe që do të bazohet në ligj. Çdo vit, ri-organizohet zyra që t'i përshtatet ndryshimeve, dhe të gjitha aranzhimet që bëhen janë të bazuara në merita. Ushtruesja e detyrës të auditorit të përgjithshëm ka punuar në ZAP tash 8 vite, dhe ka krijuar një pasqyrë se si funksionon zyra jonë. Pra, është duke u ndërtuar një institucion për të ardhmen, në pajtueshmëri me praktikat dhe standardet Evropiane.”

Kur është fjala te komunat, raporti i auditimit vjetor që do të jetë gati në fund të gushtit, adreson saktësisht këto është se për cilat komuna bëhet fjalë dhe pse. Gjatë këtyre 3 viteve kemi arritur që 18 komuna të audituara nga kompani private, dhe sezonin e ardhshëm do ta zvogëlojmë këtë në vetëm 4-5 komuna, dhe në të ardhmen shpresojmë kur të i rrisim resurset, shpresojmë që ta zvogëlojmë këtë numër edhe më shumë. Por, së shpejti Kosova do të jetë vendi i parë në botë që do të ketë një skemë certifikim që është në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare. Kjo është një gjë shumë e mirë për Kosovën.”

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Raporti i performancës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, nuk procedohet në mbledhje plenare për shqyrtim përderisa në Kuvend nuk procedohet edhe raporti i auditimit të pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2012.
2. ZAP mund të dërgoi raport shtesë bashkë me pasqyrat e audituara financiare, në mënyrë që Komisioni të ketë pasqyrë të qartë për performancën e ZAP-it për vitin 2011.

4. Të ndryshme

a). Shqyrtimi i Pikës P21 të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian

Kryetari - Sipas Raportit të Progresit dhe Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian, auditimi i jashtëm duhet të forcohet. Kuvendi në vazhdimësi ka përkrahur ZAP-in për rritje të kapaciteteve të ZAP-it me qëllim të krijimit të një institucioni të qëndrueshëm dhe efikas.

Armend Zemaj – Azhurnimi i kornizës ligjore për sigurimin më të mirë të ZAP-it, zgjerimi i fushave të reja të auditimit, ngritja e kapaciteteve të brendshme me auditorë të certifikuar, janë rezultate që tregojnë avancim më të mirë në ZAP. Po ashtu propozoi që Komisioni të ftojë në takim drejtorin e Agjensionit kundërrikorrupsion për të raportuar për raportet e audituara.

Valbona Dibra – Është shqetësuese rekrutimi i stafit që po bënë ZAP-i. Ka 10 vite dhe nuk ka staf për auditim të performancës! ZAP ka staf të përgatitur për të bërë një punë të tillë. Ishte e mendimit që të formohet një komision për të bërë një auditim të resurseve njerëzore në ZAP. Propozoi që Komisioni të diskutoi në mbledhjen e radhës për Raportin që do të procedohet në KIE lidhur me Planin e Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian.

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se KPMK ka kërkuar anulimin e konkursit për rekrutimin e 10 auditorëve të rinj. Këtë çështje Komisioni do ta sqarojë në mbledhjen tjetër kur do të diskutojë përsëri raportin e ZAP-it me pasqyrat e audituara financiare. Lidhur me propozimin e deputetit Armend Zemaj për të ftuar në raportim drejtorin e Agjensionit kundërrikorrupsion, ishte i mendimit që deputeti Armend, të hartoi platformën lidhur me këtë propozim dhe t'ja paraqes Komisionit.

Ramiz Lladrovci – Tha se Komisioni duhet të kryej aktivitete e parapara me Planin e Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian, meqenëse koha është e shkurtër dhe kjo çështje duhet të përfundojë në muajin maj.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Lidhur me Planin e Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian, Komisioni do të diskutojë edhe në mbledhjen e radhës dhe do të përgatisë raportin për Komisionin për Integritet Evropian.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu